REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1000120
Datë/Datum. 07.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	25.11.2020	07.12.2020

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.11.2020, OE "Ejona", ka parashtruar ankesë me nr: 1000/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Rima Engineering", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Vendosja, rregullimi dhe riparimi i ashensorëve", me nr. të prokurimit: 616-20-2517-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00€.
Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 11.06.2020, data e hapjes së ofertës: 07.07.2020, data e vendimit për dhënien e kontratës: 03.11.2020, data e njoftimit të me letër standarde: 03.11.2020
Ankesa është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues, ne ankesen e tij ka pretendime lidhur me oferten te rekomanduarit per kontrate, per te cilin pretendon se nuk i ka plotesuar kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, pastaj pretendon se edhe kerkesa nuk i ploteson konkretisht lidhur me pervojen e stafit profesional te kerkuar ne dosje te tenderit dhe ne fund pretendon se nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, konkretishte nenit 72 te LPP-se, lidhur me deshmit e dorezuraa nga i rekomanduari per kontrate gjate fazes se rivleresimit.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kapaciteti Teknik dhe Profesional:
Kerkesa:
1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te kësaj natyre ne vlere minimale prej 300,000 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për

kontratë).

Deshmia:
1.OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten certifikatat për kryerje te punëve.

Kerkesa 2:
a.)Inxhinier i diplomuar ose bachelor i elektroteknikes. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 3 kontrata të natyrës së ngjashme.
b.)Inxhinier i diplomuar ose bachelor i makinerisë. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 3 kontrata të natyrës së ngjashme.
c.) 3 ekipe me nga 2 teknikë. Minimumi 3 vite përvojë pune në punë të ngjashme.

Deshmia 2:
2.CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
OE ankues është i përgjegjshëm
OE i rekomanduar per kontratë është i përgjegjshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1
Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas pranimit te vendimit te PSH-se, e ka kthyer ne rivleresim aktivitetin e prokurimit ne fjale dhe sipas udhezimeve te dhena ne raportin e ekspertizes dhe vendimi e PSH-se nr. 618/20, AK-ja ka kerkuar sqarime lidhur me mungesen e dokumentacionit dhe informacionit qe ka munguar ne oferten e te rekomaduarit per kontrate.

Konkretishte AK-ja, ka kerkuar deshmit lidhur me referencat e stafit te cilat ne pergjigje te kerkeses se AK-se, OE i rekomanduar per kontrate me daten: 30.10.2020, i ka dorezuar te gjitha deshmit sipas kerkeses se AK-se.

Eksperti shqyrtues, pasi i ka analizuar deshmit e prezantuara ne sistemin e E-prokurimit, deshmit e dorezuara nga i rekomanduari dhe ne pergjigje te pretendimit te OE ankues, vlereson se i rekomanduari per kontrate ka dorezuar deshmi ne kundershtim ne paragrafin 3 te nenit 72 te LPP-se, per faktin se disa nga deshmit/referencat qe i ka prezantuar mbajn daten 15.10.2020 dhe poashtu ka deshmi te cilat e kan daten e fiksuar 30.10.2020.

OE ankues poashtu pretendon se ne deshmit e dorezuara me daten: 30.10.2020, OE i rekomanduar ka dorezuar edhe nje reference e cila nuk ka qene fare ne listen e kontratave, eksperti shqyrtues, vlereson se qendron ky pretendim, mirepo sqaron se nuk ka asnje efekte fakti qe kjo reference nuk eshte e shenuar ne listen e kontratave, por fakti qe e njejta deshmi mban daten: 15.10.2020, e ben te pavlefshem dhe ne kundershtim me nenin 72.3 te LPP-se dhe njeherit sqaroj se keto deshmi nuk eshte dashur te merren parasysh nga ana autoriteti kontraktues.

Sa i perket pretendimit se stafi profesional nuk e permbush kerkesen e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate lidhur me pervojen e stafit, qendron per faktin se perkunder mundesise se dhene gjate fazes se rivleresimit OE i cili eshte edhe me cmim me ulet nuk ka arritur te deshmoj se i njejti i ploteson kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimt per kontrate.

Ne fund eksperti shqyrtues, vlereson se pretendimet ankimore te OE ankues te parashtruar ne ankesen e tij jane te qendrueshme dhe njeherit sqaroj se dokumetet e prezatuara nga i rekomanduari per kontrate jane ne kundershtim me nenin 72.3 te LPP-se ku thuhet: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.
Ne rastin konkrete deshmit mbajne daten 15.10.2020 dhe 30.10.2020 qe i bie se disa nga keto deshmi jane mbi pesë (5) muaj pas dorezimit/hapjes se ofertave dhe njeherit eksperti shqyrtues, sqaron se disa nga keto deshmi i bashkangjes si prova me kete raporte.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, ndersa vendimi i AK-së për dhënie te kontrates te anulohet dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA PRISHTINË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - EJONA.

FISI GOLD	Referencë	faqe 1 nga 1

FISI GOLD SHPK

Prishtinë

Rr.Agim Ramadani,Nr. 18/3,
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

Datë
15/10/2020

Për të gjitha palët e interesuara

Letër Rekomanduese

Fisi gold Sh.P.K. dhe O.E.**"Rima Engineering"Sh.P.K.**, me Numër Unik Indentifikues: 810487539, Prishtinë, kanë nënshkruar Kontratën për Furnizime dhe montime:

Titulli i Kontratës:**" Furnizimi dhe montimi i ashensorit Hotilerik"**

Kontrata është nënshkruar me date: 26.02.2020.

Vlera e kontratës është: **29,800.00€.**

Konfirmojmë se kontrata është implementuar dhe furnizimet janë liferuar dhe montuar me sukses, duke u mbikqyrur nga dy Inxh. pergjegjes Vehbi Selmani - Makineri dhe Salih Gjonbalaj - Elektrike

Ju lutem për çfarëdo informate shtesë të na drejtoheni lirisht.

Sinqerisht,

Fisi Gold Shpk.

Email: fisigold@gmail.com

Fisi - Gold
Jewellery
AGIM RAMADANI 18/3
PRISHTINË

rima ENGINEERING	*Nr. i Prok.:* **"616-20-2517-5-2-1"** – *Titulli:* **"Vendosja , rregullimi dhe riparimi i ashensorëve"**

DEKLARATË NËN BETIM

Për: **Komuna e Prishtinës**

Nga: **Rima Engineering LTD**

Prishtinë: 30.10.2020

Deklarojmë më pergjegjesi morale dhe materiale se Salih Gjonbalaj ka menagjuar në mënyrë të sukseshme pjesët energjetike të liftave, shkallëve lëvizëse, platformave të ndryshme, shiritave transportues në miniera për më shumë se 5 vite. Ai vazhdon edhe më tutje të kryej menagjimin e po të njejtave detyra në Rima Engineering.

Po ashtu deklarojmë me pergjëgjesi morale dhe materiale se Vehbi Selmani që nga viti 2014 ka menagjuar në mënyrë të sukseshme pjesën mekanike të liftave, shkallëve lëvizëse, platformave të ndryshme dhe ka përvojë më shumë se 5 vite në menagjimin e kontratave dhe detyrave të natyrës së ngjajshme dhe vazhdon edhe më tutje të kryej menagjimin e po të njejtave detyra në Rima Engineering.

Me poshte ju mund ti gjeni kontratat në të cilat ata kan qenë projekt menagjer dhe udhëheqës të sektorëve përkatës.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj.

Ju faleminderit!

Me respekt,

Rima engineering LTD.

Fehmi Azemi, Drejtor

rima ENGINEERING LTD.
PRISHTINË - KOSOVË

NARTEL
CONSTRUCTION DESIGN COMPANY

TÜVRheinland CERT ISO 9001
TÜV CERT EN ISO 9001:2000 Zertifikat:75.100.40411
TÜV Rheinland InterCert

Prishtinë, Rr. Ali Vitia, Tel/Fax +381 38 612 795, +381 38 612 940, +383 44 505 008, NRB:810521585, nartel1@gmail.com

NARTEL SH.P.K
Prishtinë
Rr.Ali Vitia, Kalabri,
Datë: 15/10/2020
Prishtina 10000, Republika e Kosovës

Për të gjitha palët e interesuara

Letër Rekomanduese

NARTEL Sh.P.K. dhe **O.E."Rima Engineering" SH.P.K.**, me Numër Unik Indentifikues: 810487539, Prishtinë, kanë lidhurë Kontratën për Furnizime dhe montime:
Titulli i Kontratës:" Furnizimi dhe montimi i ashensorëve dhe eskalatorëve (shkallëve lëvizëse elektrike)", në Kompleksin afaristo banesor „Nartel Center" në lagjen Lakrishtë
Kontrata është nënshkruar me datë: 12.09.2019.
Vlera e kontratës është: 182,000.00€.
Konfirmojmë se kontrata është implementuar dhe furnizimet janë liferuar dhe montuar me sukses, duke u mbikqyrur nga dy Inxh. përgjegjës Vehbi Selmani - Makineri dhe Salih Gjonbalaj - Elektrik
Ju lutem për çfarëdo informate shtesë të na drejtoheni lirisht.

Sinqerisht,
Nartel Sh.pk.
044 505 008
Email: nartel1@gmail.com

Sh.p.k
NARTEL
CONSTRUCTION DESIGN COMPANY
10000 Prishtinë, Ajdin Ramadani 22/49